



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin shtator 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin e muajit shtator 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Muaji shtator ka qënë një muaj tepër dinamik dhe i mbushur me aktivitete nga fusha të ndryshme lidhur me mbështetjen dhe promovimin e bizneseve. I dedikuar fuqisë së grave sipërmarrëse në ekonomi dhe jo vetëm, produkteve “Made in Albania”, agroturizmit, bashkëpunimit me diasporën për të nxitur një klimë të qëndrueshme investimesh të huaja në Shqipëri dhe duke mos lënë mbrapa inovacionin dhe startupet në ekosistemin tonë që rritet cdo ditë nga të rinj që kërkojnë të sjellin idetë e tyre në realitet duke dhënë zgjidhje për probleme të ndryshme.

Si cdo muaj, nuk munguan vizitat në biznese dhe kontakti i drejtpërdrejtë me sipërmarrës të ndryshëm për të adresuar kërkesat apo ankesat e tyre me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të shpejta dhe efikase, duke vijuar kështu qasjen tonë për të qenë kurdoherë krah sipërmarrësve. Përsa i përket rrjetit të koordinatorëve të biznesit, këtë muaj nëpërmjet koordinimit teknik efikas dhe vullnetit për të trajtuar me përpikmëri cdo ankesë që është listuar në sistem janë munduar të trajtohen me përgjigje dhe zgjidhje rreth 288 ankesa biznesi, midis të cilave jam krenar të deklaroj që kemi pasur dhe raste historish suksesi.

Dëshiroj të ndaj me ju dhe dy prej eventeve ndërkombëtare ku u ftova të merrja pjesë si anëtar paneli në World Business Angels Investment Forum (WBAIF) ku u diskutua mbi “Etikën e Lidërsipit në kohë krize”. Diskutuam dhe ndamë eksperiencën mbi menaxhimin

e pandemisë si dhe sfidat me të cilat po përballemi globalisht me personalitete të shquar dhe me përvojë. Eventi i dytë HORASIS - i cili shërben si një "Think Tank" i pavarur ndërkombëtar i orientuar drejt inovacionit dhe zhvillimit të tregjeve të qëndrueshme. Së bashku me senatorin amerikan Michael D. Brown, nën moderimin e profesorit të Harvardit Paul Sheard, patëm një diskutim të frytshëm mbi krizën që ka mbërthyer gjithë botën si dhe sfidat kryesore me të cilat po përballen ekonomitë botërore.


Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,


Eduard Shalsi

Analiza e Ankesave Gusht 2020


1. Shperndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë

